



Manuar / Dorezuar Primi/eno/Prodato Received/Delivery	21. 07. 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHECK	5318/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.820/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 820/2023 të datës 06.06.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.07.2023, mori këtë;

V E N D I M

HEDHET poshtë, si e palejuar ankesa A.nr. 820/2023 të datës 06.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 10.02.2012 në pozitën "Asistent i Teknologjisë Informative, në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 06.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4607/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin për kushtet të tregut të punës, sipas Rregullores (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 08.06.2023, për mes e-mailit ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli, me datë 07.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4607/2023 e datës 06.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për shtesa e datës 14.03.2023; Plani për menaxhimin e kontratës; Akt Emërimi i datës 10.02.2012; Përshkrimi i detyrave të punës; e- maili i datës 08.06.2023; e- mali i datës 01.03.2023; lista e pagave; Përgjigje në ankesë e datës 05.07.2023, me numër protokollit 820/2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse:**

Në bazë të shkresave të lendes, Kolegji konstaton se ankuesi mbanë pozitën „Asistente i Teknologjisë Informative“ sipas Akt Emërimit të datës 10.02.2012 në Ministrinë e Shëndetësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka dërguar tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, propozimin për shtesa për kushte të tregut, pasi që ankuesi mbanë pozitën Zyrtar i Teknologjisë Informative, andaj kolegji pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të gjitha provat dhe faktet relevantë lidhur me perëndimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi _____ ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar si të parakohshme, sepse Ministria e Shëndetësisë e ka propozuar ankuesin në listën lidhur me kompensimin për kushtet të Punës, sipas Rregullores (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, por Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ kompetent deri në parashtrimin e ankesës nuk ka vendosur lidhur me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, prandaj si rrjedhojë ankuesi ka parashtruar ankesë duke mos pasur akt administrativ me të cilin ju ka mohur e drejta e tij për të përfshirë në kompensimin lidhur me shtesën për kushtet e tregut të punës.

Ndërlidhur me këtë që u tha më lartë, ankuesi ka parashtruar ankesë në kundërshtim më me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, si dhe në kundërshtim me nenin 24 , paragrafi 3 Ligjit NR. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji, si dhe në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2,3 nen paragrafi 3.1,3.2,3.3 dhe 3.4, paragrafi 5, nen paragrafi 5.1 Rregullores (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ku thuhet se; 2. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore e secilit institucion përgatitë listën e të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret e kësaj Rregullore dhe e përcjellë atë tek Komisioni sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. 3. Lista e të punësuarave, sipas paragrafit 2 të kësaj Rregulloreje, duhet të përmbajë të dhënat si në vijim: 3.1.emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil; 3.2.positën e nëpunësit civil; 3.3.përshkrimin e detyrave të punës; dhe3.4.propozimin e arsyetuar për nivelin e shtesës 5.Pas pranimit të rekomandimeve finale të nxjerra nga Komisioni, Ministri përgjegjës për Financa mund të: 5.1. aprovoj/aprovoj**

pjesërisht ose refuzoj listën përfundimtare të përfituesve me vlerat e shtesave përkatëse përmes një Vendimi të arsyetuar, Kolegji konstaton Ministria e Shëndetësisë, Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore, me datë 01.03.2023, për mes e- mailit ankuesin e ka propozuar tek Komisioni përkatës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, por MFPT nuk ka marr ende vendim, të gjitha pretendimet e ankuesit janë se MSH nuk ka dhënë përgjigje lidhur me kërkesën e tij për përfshirje në listë e lartpërmendur, mirëpo MSH nuk është kompetent që ankuesin ta kompensoj për kushtet e tregut të punës, por për këtë është kompetent MFPT, ndërsa MSH ka propozuar ankuesin në Komisionin përkatës të MFPT lidhur me shtesat e lartpërmendura.



Ndërlidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshilli, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi ka qene i obliguar që ankesën ta parashtrojë në pajtim me ligjin për zyrtarët publik.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.820/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës


Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.